



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:264779
Datë: 29.12.2023
Numri i dokumentit: 05141145

C-IV.-14-3363

Parashtruesi i ankesës:

N T, G, Lipjan

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore “Tregtia”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Manushe Karaçi më 29 dhjetor 2023, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- I. Ankesa e parashtruesit hedhet poshtë si e papranueshme.**
- II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 30 prill 2014, parashtruesi ka dorëzuar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër vendimit GJI097-0171, të nxjerrë nga Autoriteti i Likuidimit të AKP-së më 28 mars 2014.

Parashtruesi ka kërkuar nga gjykata që të merr parasysh kërkesën e tij për kompensimin e 3 pagave për ndërprerje të parakohshme të kontratës në ndërmarrjen shoqërore ‘Tregtia’, e cila ishte refuzuar si e pavlefshme nga AKP-ja.

Ankesën kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, parashtruesi e dorëzoi për shkak të:
-Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe
-Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Tutje, parashtruesi theksoi se ka qenë në marrëdhënie të rregullte të N.T.SH “Tregtia” në Ferizaj, ku ka realizuar të ardhurat personale dhe me vendimin e AKP-së të cekur më lartë i është shkelur e drejta nga marrëdhënia e punës për mos pagimin e tri pagave për muajin Mars, Prill, Maj të vitit 2008 si dhe me ndërprerjen e punës sipas kontratës janë shkelur të drejtat e punëtorit. Këtë e ka bazuar në nenin 11 dhe 12 të Rregullores 2001/27 të ligjit themelor të punës në Kosovë.

Kësisoj, parashtruesi kërkon nga gjykata që të pranohet si e bazuar kërkesa e tij si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që në emër të dëmshpërblimit për tri pagat e fundit t’i paguajë menjëherë, në shumë prej 450.00 euro si dhe dëmshpërblimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës-kontratës në shumë prej 4,950.00 euro.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi për gjykatën ka prezantuar:

- *Kopjen e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 27 maj 2008;*
- *Kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. GJI097-0172 i datës 28 mars 2014;*
- *Kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. GJI097-0171 i datës 28 mars 2014;*

Sa i përket pagave të papaguara, AKP-ja, kërkesën e refuzoi si të pavlefshme duke u bazuar në Nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në i cili parasheh që: “elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:...kërkesa apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme;”

AKP-ja, kërkesën për dëmshpërblim e refuzoi si të pavlefshme duke u bazuar në Nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në i cili parasheh që: *parashtruesit gëzojnë të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të punës nëse ‘janë pushuar nga puna si pasojë e, ose në lidhje me, një veprim të AKP-së sipas Nenit 6.1 ose 6.2’.*

Tutje në vendim AKP-ja theksoi se privatizimi ka hyrë në fuqi më 27 maj 2008 dhe marrëdhënia e punës së gjithë punonjësve aktiv të ndërmarrjes është ndërprerë me këtë datë. Ky Autoritet i Likuidimit konstatoi se gjatë kësaj periudhe parashtruesi i kërkesës nuk ishte punonjës aktiv i NSH-së dhe se nuk ka ofruar shërbime për ndërmarrjen për periudhën e lartpërmendur. Andaj, AL-ja ka vërejtur se parashtruesi i kërkesës nuk është pushuar nga puna si rezultat i privatizimit të NSH-së.

Më 22 korrik 2022, parashtruesi i ankesës ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 30.00 euro sipas Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Më 22 gusht 2023, AKP-ja dorëzoi mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit të dorëzuar më 5 maj 2014 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI097-0171 të datës 28 mars 2014 të NSH-së “Tregtia”.

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të

Likuidimit GJI097-0171 të datës 28 mars 2014.

Më 10 gusht 2023, në bazë të nenit 38 paragrafi 1, i Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme, gjykata lëshoi një urdhër me të cilin nga ankuesi u kërkua që në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të këtij urdhri, të dorëzojë në gjykatë ankesën e precizuar kundër vendimit të kundërshtuar si dhe prova tjera shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore. Parashtruesit të ankesës iu është bërë me dije lidhur me pasojat juridike në rast të mospërmbushjes së urdhrit të gjykatës.

Në bazë të fletëkthesës e cila gjendet në shkresa të lëndës gjykata vëren se më datën 22 gusht 2023, parashtruesi i ankesës e ka pranuar urdhrin e gjykatës por gjer më sot nuk ka dorëzuar provat për të mbështetur kërkesën kreditore.

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa e parashtruesit hedhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në kuptim të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktvendim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtruesat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuar).

Pika 3 e këtij neni parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Dhoma e Posaçme, pasi që shqyrtoi ankesën e dorëzuar dhe shkresat e tjera të lëndës konstatoi se ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. Neni 36 paragrafi 2 pika 2.5 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se *”kërkesa/ ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji”*.

Neni 35 paragrafi 2 pika 2.4 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se ankesa duhet të përmbajë: *“lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që parashtruesi synon t'i paraqes”*.

Parashtruesi ka dorëzuar Kopjen e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 27 maj 2008, Kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. GJI097-0172 i datës 28 mars 2014, Kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. GJI097-0171 i datës 28 mars 2014. Megjithatë parashtruesi nuk ka dorëzuar ankesën e precizuar kundër vendimit të

kundërshtuar.

Parashtruesit gjykata i bën me dije se sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Për më tepër edhe në bazë të nenit 31, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili përcakton se: *'Palët, në parashtrësit e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës'.*

Me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashihet që: *'në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore'.*

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në pajtim me nenin 33 paragrafi 1 dhe nenin 36 paragrafi 2 pika 2.3 e Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

GJYQTARJA,
Manushe Karaçi